



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA DIVJAKE

PLAN
MBARËSHTRIMI
PËR PYJET
(2025-2035)

PËR NGASTRAVE PYJORE Nr :

**10a/11a/11b/11c/12a/17a/19a/19b/20a/21a/21b/21c/22a/22b/22c/22d/23a/24a/24
b/25a/25b/26a/26b/27a/27b/29a/30a/30b/31a/32a/33a/34a/34b/35a/36a/36b/38a/
38b/39a/39c/40a/40b/40c/25b.**

TË EKONOMISË PYJORE TË BASHKISË DIVJAKË

Për periudhën 2025-2035

PËRGATITI PROJEKTIN: Ing. Selim Lisha

DREJTUES TEKNIK I PROJEKTIT: Ing. Selim Lisha

PROJEKTI U APROVUA NË KOMISIONIN TEKNIK PRANË BASHKISË

DIVJAKË

MË DATË _____

PROJEKTI U MIRATUA NË KËSHILLIN E BASHKISË DIVJAKË

ME VENDIMIN NR ____ Datë _____

SEKRETARI

KRYETARI

KRYETARI I BASHKISE
Josif Gorrea

BASHKIA DIVJAKË

Bashkia Divjakë kufizohet në veri me bashkinë Rrogozhinë.

Në lindje me bashkinë Lushnjë.

Në jug me bashkinë Fier.

Në perëndim me Detin Adriatik.



Përmbajtja e projektit

Kapitulli i I

ASPEKTE TË PERGITHSHME

1. Hyrja
2. Dy objektivat kryesore
3. Detyrat e projektit
4. Qëllimet e planit të menaxhimit
 - 4.1. Qëllimet e mbarështrimit
 - 4.2. Objektivat e planit të mbarështrimit
 - 4.3. Ndër objektivat kryesore
5. Apektet historike
6. Territori dhe vegjetacioni

Kapitulli i II

PJESMARRJA E KOMUNITETIT

Pjesëmarrja e komunitetit lokal dhe analiza social ekonomike.

1. Pjesëmarrja e popullatës.
 - 1.1. Pjesëmarrja e komunitetit.
 - 1.2. Evidentimi i funksioneve te pyjeve.
 - 1.3. Funksionet ekologjike.
 - 1.4. Funksionet ekonomike.
 - 1.5. Funksionet sociale - kulturore
2. Analiza Social ekonomike.
3. Të dhënat demografike
 - 3.1. Përdorimi I tokës bujqësore

3.2. Bujqësia e qëndrueshme dhe Teknologjia

4. Llojet e blektorisë dhe numri i krerëve.

4.1. Kullotja

5. Produktet pyjore që përdoren

5.1. Llojet më të përdorura.

5.2. Zonat konkrete ku prodhohen.

Kapitulli i III

MJEDISI EKOLOGJIK

1. Shtrirja, pozita gjeografike dhe kufinj të.

1.1. Shtrirja dhe Tipologjia .

1.2. Pozita Gjeografike dhe Rajonale.

1.3. Forma e Territorit dhe Relievit.

2. Tokë dhe origjinë

2.1. Kushtet e punës

2.2 Hidrologjia dhe ndikimi i ujit

2.3. Pjerrësia

2.4. Relievi.

2.5. Rrjeti rrugor.

2.6. Erozioni.

2.7. Erozioni bregdetar.

2.8. Faktorët që nxisin erozionin.

2.9. Pylli I Gradishtë-Gjenerukës dhe rreziku I erozionit .

3. Studimi i Tokës.

3.1. Funkzionet e pyjeve dhe rëndësia ekologjike .

3.2. Struktura e Tokës dhe bimësia tipike.

3.3. Mbarështrimi dhe funksionet.

4. Rekomandimet për një studim lokal dhe pyjeve në rajonin Gradishtë-Gjenerukë.

4.1.Karakterizimi i Tokës.

4.2. Hartëzimi i mbulimit bimorë.

4.3.Analiza ekologjike .

4.4. Vlerësimi i shkallës së erozionit dhe ndikime.

5. Rekomandime dhe menaxhime.

5.1. Sipërfaqja e verifikuar.

6. Vegjetacioni dhe biodiversiteti.

6.1.Biodiversiteti.

6.2.Pylli i Senzës.

6.3. Vegjetacioni i mundshëm.

6.4. Biodiversiteti i mundshëm.

7. Bashkëshoqërimet e bimëve barishtore dhe druosre.

7.1. Funksionet ekologjike.

7.2. Parandalimi i erozionit.

7.3. Pastrimi i ajrit.

7.4. Ruajtja e biodiversitetit.

7.5. Habitat për faunën.

7.6. Marështrimi i faunës së egër.

7.7. Bimët mjekësore.

Kapitulli i IV

ANALIZA E PYLLIT

1.Objektivat e mbarështrimit.

1.2. Objektivat kryesore.

1.3. Objektivat specifike për ekonomin pyjore.

2. Taksimet dhe vëzhgimet biometrike.

3. Pasqyra e llojeve të druve dhe shkurreve.

Kapitulli i V

1.Përshkrimi parcelar.

Kapitulli i VI

1.Aspektet organizative për zbatimin e projektit.

1.2. Objektivat silvi kulturor.

1.3. Prerjet teknike dhe masat për zbatimin.

1.4. Prerje pastruese.

1.5. Prerje selective.

1.6. Zbatim praktikë.

Kapitulli i VII

HARTAT



KAPITULLI I PARË

1. HYRJE

Në kuadër të reformave të ndërmarra në të gjitha fushat e ekonomisë kombëtare, edhe sektori i pyjeve ka pësuar ndryshime të rëndësishme me qëllim rritjen e efektivitetit në menaxhim dhe garantimin e një përdorimi më të qëndrueshëm të burimeve natyrore. Si pjesë e këtyre reformave, administrimi i pyjeve i është deleguar bashkive vendore, duke sjellë përgjegjësinë më afër komuniteteve dhe rritur mundësinë për një menaxhim më të kujdesshëm dhe më efikas.

Në këtë kontekst, **Bashkia Divjakë** ka në administrim **640.98 hektarë pyje**, të cilat përbëjnë një aset të rëndësishëm natyror, ekonomik dhe mjedisor për zonën. Këto pyje ndodhen në një territor me vlera të larta ekologjike, përreth Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta, një nga zonat më të mbrojtura dhe më të pasura në biodiversitet në Shqipëri. Ato ndikojnë ndjeshëm në ruajtjen e ekuilibrave ekologjike, përmirësimin e cilësisë së ajrit, mbrojtjen e tokës nga erozioni, si dhe në ruajtjen e ujërave të nëntokës dhe të lagunave përreth.

Për shkak të ndryshimeve të dukshme që kanë ndodhur në gjendjen e pyjeve, si në përbërjen drusore, në dendësi dhe në ndikimet antropogjene (shfrytëzim i pakontrolluar, zjarre, ndërhyrje të paligjshme), është bërë i domosdoshëm hartimi i një projekti të ri mbarështimi, me synimin për të përmirësuar cilësinë e këtyre sipërfaqeve dhe për të garantuar një përdorim afatgjatë e të qëndrueshëm.

2. Ky projekt synon të realizojë dy objektiva kryesorë:

a. Hartimin e masave silvo-teknike për rehabilitimin dhe zhvillimin e pyjeve, me qëllim rritjen e prodhimtarisë drusore dhe forcimin e funksioneve ekologjike të pyllit;

b. Zhvillimin e një menaxhimi të bazuar në kritere ekonomike e mjedisore, që siguron përdorimin racional të burimeve pyjore, pa cenuar të drejtat e komunitetit lokal dhe duke mbështetur zhvillimin rural të zonës, në përputhje me politikat e njësisë vendore.

Pyjet e Divjakës, përveçse një pasuri natyrore, janë gjithashtu pjesë e identitetit lokal dhe një burim potencial për zhvillimin e turizmit natyror dhe edukimit mjedisor. Ky plan mbarështimi vjen si një hap i domosdoshëm për të ruajtur këtë pasuri të përbashkët dhe për të garantuar që ajo t'u shërbejë brezave të tanishëm dhe atyre të ardhshëm.

Në të njëjtën kohë duke parë se pyjet tradicionalisht kanë qënë në funksion të nevojave të komunitetit që ka jetuar e jeton për material drunor dhe bazë e furnizimit për blektorinë e bujqësinë nëpërmjet trajtimit dhe ushtrimit me rigorozitet të masave teknike të parashikuara do të jetë burim furnizimi e fitimi. Në objektin e marrë në studim në kohë e vite nuk janë kryer asnjë punim. Nëpër sipërfaqet e këtyre ngastrave jo rallë gjenden edhe mure të rënuar të ndërtesave gjë që tregon se njerezit më parë i kanë shfrytëzuar të ardhurat e pyllit dhe kanë jetuar po aty, pranë pronave që shërben për të ardhurat e tyre. Në një vështrim, në kufirin e këtyre ngastrave në anën veriore të tyre pylli është shfrytëzuar, pra është trajtuar me prerje rigeneruese para afërsisht tri dekadave në bazë të regjimit të pyllit. Kjo shton ambicien jo vetëm për të ardhurat por për një vazhdimësi të sigurt dhe të mbarë të pyllit në këtë zonë. Tranzicioni gjatë periudhës së sistemit dhe periudha e tanishme nuk kanë qenë trajtuar me prerje abuzive këto parcela pyjore. Kjo është edhe si rezultat i largësisë nga qendrat urbane dhe largësia nga rruga automobilistike. Në të njëjtën kohë kjo është

edhe falë kulturës për mbrojtien e pyjeve nga banorët e komunitetit të zonës së Divjakës. Në të njëjtën kohë rol kan luajtuar edhe bashkëbisedimet dhe eksperiencave me komunitetin në kohë të fituara falë emigracionit të hershëm të zonës. Hartimi i këtij plani është një punë e përbashkët me Pushtetin Vendor, me gjithë strukturat e tyre, me një pjesëmarrje të gjerë mendimesh, në mënyrë që ky plan të jetë i zbatueshëm e rezultativ dhe te garantojë një plotësim të nevojave të komunitetit pa cënuar vijshmërinë e tij. Ajo cfarë duhet të themi është se kv plan mbarështrimi i pjesëshëm nuk prek sasinë e disponueshme të blektorisë që disponon komuniteti i banorëve vendas. Këtij qëllimi i shërbeu marrja e mendimeve nga banorë, specialistë e drejtues të Bashkisë në menyrë që edhe vetë Bashkia të shtojë interesin në të ardhmen për këto prona me rendësi të ekonomise. Kjo i shërben edhe më tepër shfrytëzimit të resurseve natyrore që ka kjo Bashki. Masat, faktore dhe ushtrim i trajtimit të pyllit pasurohen plotësisht në këtë projekt.

3. Detyrat e projektit

Pika kryesore e detyrës së projektimit ,ka qënë projektimi I planit ë mbarështrimit të pyllit.Ky plan mbarështrimi , ka filluar me kryerjen e rievimeve në terren dhe plotësimin e skedave përkatëse dhe grumbullimin e gjithë informacionit të nevojshëm , përpunimin e të dhënave në zyrë dhe përpilimin e materialit hartografik, duke zbatuar me korrektësi manualin e mbarështrimit,

4. Qellimet e planit te menaxhimit.

Në hartimin e këtij plani mbarështrimi (i disa parcellave pyjore) ka si qëllim në vete të arrihen objektivat që përcaktohen në hyreje të këtij plani:

1. Të bëhet përshkrimi i sipërfaqeve për çdo ngastër pyjore që do ti nënshtrohen punimeve silvo teknike.
2. Të bëhet përpilimi i hartave përkatëse
- 3.Të bëhet përshkrimi i funksioneve kryesore të këtyre pjesëve dhe mbarshtohen duke gërshetuar interesat bashkiake me ato të pyllit dhe limitet e përcaktuara nga legjislacioni aktual.
4. Të bëhen matjet për përcaktimin e gjendjes aktuale për vëllimin sipas llojeve.
5. Të bëhet përskrimi i masave silvo teknike që do të kryhen, duke përfshirë këtu llojin e punimit, objektin ku do të kryhet, marrjen e masave për mbrojtjen e tij etj. Në të njëjtën kohë të përshkruhet edhe procesi teknologjik i prerjeve rigjeneruese si dhe masa të tjera për fillimin e procesit të konversionit.
6. Të jepet informacion mbi florën dhe faunën.
7. Të bëhet përshkrimi për hidrografinë, klimën dhe tokën.
8. Të bëhet një përshkrim i të dhënave demografike.
- 9.Të bëhet përcaktimi i sasisë së materialit drusor që konsumohet, (ngrohje gatim,etj.)

4.1. Qëllimet e mbarështrimit

Shfrytëzimi dhe perdorimi me kujdes i resurseve natyrore, është një dhuratë që I përketë këtij vendi të bekuar, e pasuri është fillimi i vlerësimit të drejtë të pyjeve të kësaj zone. Në të njëjtën kohë është edhe një hap para dhe si faktor domosdoshmërie për ruajtjen e kuilibrit të mjedisit. Në të njëjtën kohë është edhe një rregullator i mirëfilltë në ruajtjen e regjimit hidrik. Është detyrë parësore që me zbatimin e masave silvo teknike të hartuara në këtë plan mbarështrimiti që ky grumbull pyjor të arrijë qëllimin kryesor e final sipas regjimit të tij. Këtu nuk mendohet vetëm për qëndrueshmërinë e pyllit, por për përmirësim të ndjeshëm në vazhdimësinë e prodhimit sipas funksionit, rritje e cilësisë së asortimenteve të materialit drunor në të ardhmen si dhe ruajtjen e një ekuilibri të shëndoshë ekologjik. Prandaj në kuptimin më të gjerë vec funksioneve të përmendura më lartë duhet të kemi në konsideratë edhe bimët mjekësore të instaluar apo lloje drurësh industrial që me zbatimin e masave silvo teknike do të marrin më mirë kushte zhvillimi. Vlen të përmend që në ngastrat në veri të këtyre që merren në studim janë trajtuar në vitet e mëparshëm dhe zhillimi e rritja e drurëve është më cilësore dhe me parametra të kënaqshme të tyre. Kjo është njëra anë e vlerësimit të zbatimit të masave të planit të mbarështrimitit. Këtij qëllimi i përshtaten edhe kushtet e instalimit të bimësisë pyjore në këtë objekt si dhe regjimi i pyllit. Në kushtet e tanishme është detyrë primare nderhyrja me masa silvo teknike të diktuar nga ky plan mbarështrimiti.

Mbarështrimiti i pyjeve duhet të bëhet bazuar në:

- Qëndrueshmëri dhe fleksibilitet maksimal i grumbujve pyjore
- Plotësim të të gjitha funksioneve në mënyrë optimale dhe të qëndrueshme , sistemet silvikulturore dhe ato të shfrytëzimit tekniko ekonomike tu përshtaten kushteve lokale dhe atyre të grumbullit pyjor
- Intensiteti i ndërhyrjeve silvikulturore tu përshtaten objektivave, kushteve stacionale dhe grumbullit pyjor
- Parimeve të kursimit dhe ekonomizimit optimal
- Përdorimit të zhvillimeve natyrore (automatizimi biologjik)
- Promovimi dhe përmirësimi i biodiversitetit

Problem shumë i rëndësishëm, për zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve, është paksimi i presionit të kullotjes në pyjet e rinjë dhe kontrolli prerjes së druve të zjarrit.

4.1. Objektivat e planit të mbarështrimitit

Në hartimin e planit të mbarështrimitit synohen të arrihen disa objektiva kryesore të cilët janë: Bashkërendimi i të gjitha kriterëve teknike dhe sociale për të patur një qeverisje të qëndrueshme të pyjeve, për të siguruar një prodhim maksimal dhe për të plotësuar sa më kënaqshëm nevojat e komunitetit dhe të rris të ardhurat.

/Hartimi I planeve të mbarështrimitit të pyjeve bazohet në nenein 11 të ligjit 57/2020 , në datë 30.04.2020 “per pyjet” 1). Mbarështrimiti i pyjeve realizohet në përputhje me politikat dhe Programin Kombëtar të Pyjeve, duke garantuar ruajtjen , në date , zhvillimin dhe ripërtëritjen e fodnit pyjore kombëtar, sigurimin e kushteve për shfrytëzimin e tij në përputhje me prioritetet kombëtare. Mbarështrimiti i pyjeve përshtatet dhe plotësohet në përputhje me ndryshimet e gjendjes së fondit pyjor kombëtar , si dhe me ndryshimet shoqërore dhe ekonomike të vendit.

2). *Planit të mbarështrimit të ekonomive pyjore ,si dokument bazë afatgjatë për pyjet, për realizimin e qeverisjes, zhvillimin dhe mbrojtjen e tyre, i vlefshëm për një periudhë 10-vjeçare. Planet e mbarështrimit hartohen dhe pronarët përkatës sipas forms së pronësisë, bazuar në metodikat/udhëzuesit e përgatitur nga ministria, nëpërmjet eksperteve të certifikuar të fushës ose strukturave pyjore. Për të gjitha format e pronësisë, planet të mbarështrimit shoqërohet me miratimin paraprakë të këshillit bashkiak përkatës.*

4.3. Ndër objektivat kryesore :

- Cuarja e grumbujve pyjore drejt normalitetit, që garanton zhvillimin e qëndrueshëm , prodhimin maksimal si dhe ekuilibrin e kënaqshëm të ekosistemeve pyjore me mjedisin rrethues.
- Fuqizimi dhe shtimi i funksioneve të pyllit në dobi të pronarit e të popullatave lokale.
- Shtimin e efektit të grumbujve me funksion mbrojtës- prodhues.
- Përmirësimi i strukturës llojore dhe i cilësisë së grumbujve.
- Optimizimi i infrastrukturës rrugore.
- Kryerja e punimeve për sigurimin e gjeneratës së re të pyjeve në ato pjesë të territorit ku ajo mungon ose është dëmtuar.
- Të pakësoi efektin negativ të erozionit.
- Të mbrojtë resurset ujore.
- Të pakësoj ndikimet negative me gjendjen shëndetësore të pyjeve.
- Të evidentoj mundësitë për një punësim gjithë vjetore ose sezonale duke u mbështetur në resurset që ofron natyra në këtë sipërfaqe pyjore, për pronarët dhe popullatat vendase, me qëllim primar zbutjen e varfërisë në zonat rurale si dhe largimin e presionit të prerjeve të paligjshme në pyje.

5.Aspekte Historike

Divjaka është një nga zonat më të pasura të Myzeqesë, jo vetëm për bukuritë natyrore, por edhe për trashëgiminë historike, kulturore dhe etnografike. E vendosur mes detit Adriatik dhe fushave të begata, kjo zonë ka qenë e banuar që në lashtësi, me ndikime ilire, romake e më vonë osmane. Në kohë më të afërta, Divjaka është njohur për rolin e saj në zhvillimin bujqësor dhe pyjor, si dhe për ruajtjen e traditave popullore. Veshjet tradicionale të zonës, këngët polifonike, vallet e Myzeqesë dhe artizanatet janë pasuri e çmuar e identitetit lokal. Festa popullore, zakonet e vjetra dhe mikpritja e veçantë janë pjesë e gjallë e jetës në këtë bashki. Sot, përveç bukurive natyrore si Laguna e Karavastasë dhe pyjet përreth, Divjaka krenohet me trashëgiminë e saj etnografike e folklorike – një pasuri që shkon përkrah zhvillimit të qëndrueshëm dhe përpjekjeve për të ruajtur ekosistemin e veçantë të kësaj zone.Në vitet pas ndryshimeve të viteve '90, Divjaka nisi të shfaqë potencialin e saj të veçantë për turizëm dhe zhvillim të qëndrueshëm mjedisor. Krijimi i Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta në vitin 2007 përforcoi rolin historik dhe ekologjik të kësaj zone, si një hapësirë me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare për ruajtjen e biodiversitetit. Sot, Bashkia

Divjakë përfaqëson një ndër zonat më të rëndësishme të jugperëndimit të Shqipërisë për zhvillim të qëndrueshëm rural dhe ekologjik. Historia e saj është e lidhur ngushtë me harmoninë midis njeriut dhe natyrës – një lidhje që vazhdon të jetë themel për të gjitha politikatat dhe projektet në këtë territor.

6.TERRITOI DHE VEGJETACIONI

Territori i Bashkisë Divjakë shtrihet në pjesën jugperëndimore të Shqipërisë, në fushën pjellore të Myzeqesë, dhe kufizohet me detin Adriatik në perëndim. Ai përfshin një peizazh të larmishëm natyror: zona bregdetare me duna ranore, toka bujqësore, laguna, ligatina dhe sipërfaqe pyjore me rëndësi të veçantë ekologjike. Një nga pasuritë më të çmuara është Laguna e Karavastasë, pjesë e Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta, që bën pjesë në listën e zonave Ramsar për mbrojtjen e ligatinave me rëndësi ndërkombëtare. Vegjetacioni i zonës përfaqësohet kryesisht nga pyje të pishës së butë (*Pinus pinea*) dhe pishës së egër (*Pinus halepensis*), të ndërthurura me shkurre mesdhetare si dëllinja, dafinat dhe shkurret halore. Në zonat lagunore dhe të kripura hasen bimë tipike halofite. Ky mozaik vegjetativ krijon kushte ideale për mbrojtjen e tokës, ruajtjen e biodiversitetit dhe ofrimin e shërbimeve ekosistemike. Ky territor i larmishëm kërkon një vëmendje të veçantë në menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve pyjore, për të garantuar ruajtjen e funksioneve ekologjike dhe mbështetjen e zhvillimit rural e turizmit natyror.

KAPITULLI I DYTË

1.PJESEMARRJA E POPULLATES

Pyjet e marra në studim janë në juridiksionin e fshatrave si Grabian, Gërmënj Madh, Spolat, Gradisht, Kryekuq, Kamenic, Gur, Babunj, Miz. Pavarësisht që ka komision për administrim të këtyre pyjeve ato nuk funksionojnë mbasi proceset e emigrimit dhe ato demografike kanë bërë punën e tyre. Në komision për pyjet e kullotat bëjnë pjesë si më poshtë ku kryetare është kryetar i fshatit. Lidhur me pjesëmarrjen e mendimeve të komunitetit është pasur në konsideratë të realizohen kërkesat e Bashkisë si dhe të ketë vendin e duhur edhe mendimi i komunitetit të banorëve vendas. Evidentimi i funksioneve të pyjeve : Gjendja e parcelave pyjore të marra në studim në shtrirje dhe lloje si dhe vecoritë gjeografike të ekonomisë pyjore flasin për një ndërthurje të funksioneve. Ato janë pyje prodhues me regjim cungishte, pra pyje të mesëm. Në këtë njësi të qeverisjes vendore nuk mund të flitet për shfrytëzim pyjesh në këtë anë të këtyre parcelave pyjore, por vetëm për nevojat e komunitetit të bashkisë për ngrohje, e të tjera. Ndërthurja konsiston në mbrojtjet erosive dhe prodhimtari të materialit drunor. Nga ana e radhës së ndërhyrjeve mund të themi: Kjo është fillimi i mbarë i radhës së shfrytëzimit të kapaciteteve të kësaj ekonomie pyjore konform legjislacionit në fuqi nga ana e mundësive vejtore të shfrytëzimit si dhe urgjencës për ndërhyrje. Ashtu si u përmend edhe më lartë të ardhura japin blegtorinë e ardhur (kontraktimi), drurë e bimë si arra e bimë të tjera mjekësore. Një pjesë e mirë e tyre janë të instaluar edhe në ngastrat që studiohen. Pavarësisht nga menaxhimi i të ardhurave këto ngastra i janë nënshtuar një gjuetie për kafshë të egra që pavarësisht moratoriumit për gjuetinë. Në të ardhmen ky funksion duhet të bëhet gjithënjë e më i njohur dhe i shfrytëzueshëm. Niësia e qeverisjes vendore Divjakë, është e gielbëruar gjatë periudhës së pranverës dhe ka kullota të shkëlqyer për blegtorinë, por edhe për mbarështrimin e bletës.

1.1.PJESEMARRJA E KOMUNITETIT

Pjesëmarrja e komunitetit është një nga elementët kyç për mbarështimin e qëndrueshëm të pyjeve në Bashkinë Divjakë. Tradita e lidhjes së ngushtë të banorëve me natyrën, si dhe varësia nga burimet pyjore për nevoja jetike – si drutë e zjarrit, kullota për bagëtinë dhe produkte të tjera pyjore – e bëjnë komunitetin një aktor të pazëvendësueshëm në ruajtjen dhe përdorimin racional të pyjeve.

Bashkia Divjakë, në bashkëpunim me njësitë administrative, ka nxitur përfshirjen aktive të banorëve në:

- **Mbikëqyrjen dhe ruajtjen e pyjeve**, duke krijuar një ndjenjë përgjegjësie ndaj pronës publike;
- **Punët e pyllëzimeve dhe rehabilitimit**, sidomos në zonat e dëmtuara nga zjarret ose prerjet e paligjshme;
- **Ndërgjegjësimin mjedisor**, përmes edukimit të të rinjve, organizimit të fushatave dhe përfshirjes së shkollave e grupeve rinore;
- **Vendim marrjen vendore**, përmes konsultimeve publike dhe përfshirjes në hartimin e planeve të menaxhimit pyjor;
- **Zhvillimin e aktiviteteve ekonomike të qëndrueshme**, si mbledhja e produkteve jo-drusore, bletaria, ose turizmi natyror, që i lidhin drejtpërdrejt banorët me përfitimet nga pyjet.

Ky model i bashkëmenaxhimit përforcon mbrojtjen e burimeve natyrore dhe krijon mundësi për zhvillim rural, duke ruajtur ekuilibrin ndërmjet nevojave ekonomike dhe ruajtjes së mjedisit.

1.2. Evidentimi i funksioneve të pyjeve

Giendja e parcelave pyjore të marra në studim në shtrirje dhe lloje si dhe vecoritë gjeografike të ekonomisë pyjore flasin për një ndërthurje të funksioneve.

Bashkia Divjakë përfshin një nga pasuritë natyrore më të rëndësishme të Shqipërisë: i cili përmban pyje me pisha, lisa, shkoz, frashër, laguna, toka të njoma dhe një biodiversitet të rrallë.

1.3. Funksionet ekologjike në Divjakë :

- Habitat për speciet e rralla
- Ruajtja e ekosistemit bregdetar
- Filtrim natyror i ajrit dhe ujit

1.4. Funksionet ekonomike në Divjakë

- Turizmi natyror dhe ekologjik - Parku është atraksion për turistë vendas dhe të huaj, çka sjell të ardhura për komunitetin lokal nëpërmjet guidave, bujtinave dhe agroturizmit.

1.5. Funksionet sociale dhe kulturore në Divjakë

- Hapësirë për pushim dhe rekreacion – Pylli i Divjakës është vend i njohur për vizitorët që shkojnë për shëtitje, biçikletë, piknik dhe vëzhgim shpendësh.
- Identitet kulturor dhe lokal – Zona pyjore është pjesë e identitetit të Divjakës dhe një simbol krenarie për komunitetin vendas.
- Aktivitete edukative dhe ndërgjegjësuese – Organizohen shpesh aktivitete për nxënës e vizitorë mbi rëndësinë e ruajtjes së natyrës.

2. ANALIZA SOCIAL EKONOMIKE

Të dhëna demografike

Bashkia Divjakë ndodhet në Qarkun e Fierit dhe përfshin disa njësi administrative si Divjakë, Gradishtë, Grabian, Remas dhe Tërbuf. Ajo ka një strukturë demografike që pasqyron tiparet e zonave rurale të Shqipërisë – me ekonomi të bazuar te bujqësia dhe me tendencë të lartë emigrimi. • Pjesa më e madhe e popullsisë është e angazhuar në bujqësi dhe veprimtari të lidhura me të. • Ekziston një potencial në rritje për turizëm ekologjik , i cili po krijon vende të reja pune, kryesisht sezonale. • Rënie e lehtë e popullsisë në disa zona, veçanërisht në qendrat më të vogla rurale, për shkak të:

- Emigrimit të rinjve jashtë vendit dhe drejt qyteteve të mëdha.
- Lindshmëri të ulët dhe plakje graduale të popullsisë.
- Migrim i brendshëm nga zonat më të thella drejt qendrës urbane të Divjakës, që po zgjerohet si qendër administrative dhe ekonomike. Popullsia e Bashkisë Divjakë po përballlet me sfida tipike të zonave rurale në Shqipëri: emigracion të lartë, plakje natyrore, dhe mungesë të punësimit cilësor për të rinjtë. Megjithatë, mundësitë e zhvillimit që ofron turizmi ekologjik, bujqësia

moderne, dhe përmirësimi i infrastrukturës mund të ndihmojnë në stabilizimin dhe ringjalljen e zonës.

3. Të dhëna demografike

TË DHËNAT E POPULLESIS PËR BASHKINË DIVJAKË VITI 2024.

Bashkia Divjakë, Nr. i popullësis
24.882 banorë

Përbërja gjinore

Meshkuj	12.590
Femra	12.292

3.1. Përdorimi i Tokës Bujqësore

Infrastrukturë ujitjeje dhe tokë e mbjellë

Zona e Divjakës bën pjesë në fushën bujqësore më intensive të Shqipërisë, pjesë e "unazës bujqësore" të Lushnjës-Divjakës. Shumë toka janë përfituese të sistemit të ri të kanaleve të ujitje dhe drenazimit, i modernizuar që parandalon salinizimin dhe garanton furnizim të qëndrueshëm me ujë për rreth 15,000 ha sipërfaqe bujqësore.

3.2. Bujqësia e qëndrueshme dhe teknologjia

Projekt si **Urban Lab** sigurojnë analize mjedisore, testime laboratorike dhe trajnim për aplikimin e metodave ekologjike, për reduktim të kimikateve në kultivim.

Fermeret:

Rreth 70-80 % e popullsisë aktive punon në bujqësi. Fermerët kryejnë kultivime intensive te sektori hortikulturor dhe blegtoral, duke shfrytëzuar teknologji moderne për rritjen e prodhimit.

Prodhimi	Tipi i kultivimit	Sezonaliteti	Sip/ha e mbjelle
Shalqi	Hortikulture	Maj-Shtator	
Pjeper	Hortikulture	Maj-Gusht	
Patate	Perime	Janar-Shtator	
Domate,Speca,Kastravec,	Perime	Janar-Qershor	
Brokoli,Karrot,Lulelaker	Perime	Gjithe vitin	
Ullinj,Agrume,Peme	Pemtore	Shumevjecare	
Vreshta	Shkurrore	Shume vjecare	

● Tokat bujqësore të Divjakës përbëjnë model të zhvillimit bujqësor kombëtar: tokë pjellore, sistem ujitjeje modern, praktikë sipas standardeve ekologjike dhe varietete të shumta kultivimesh – nga shalqini dhe pjepri cilësor deri te perimet e freskëta gjatë gjithë vitit. Kjo zonë historikisht dhe vazhdimisht mbetet një nga qendrat bujqësore më të zhvilluara dhe më të njohura në Shqipëri dhe rajon.

4. Lloji i blegtorise dhe numuri i krereve

Divjake	600 gjedhe (Lope)	3000 te imta (Dele)
Gradisht	800 te imta (Lope)	3900 gjedhe (Dele & Dhi)
Remas	120 gjedhe (Lope)	1500 te imta (Dele & Dhi)
Grabjan	1500 gjedhe (Lope)	2500 te imta (Dele & Dhi)
Terbuf / Cerme	2000 gjedhe (Lope)	1500 te imta (Dele & Dhi)

Bashkia Divjake

Shuma totale e Lopeve	Shuma totale e Deleve & Dhive
5020 Lope	12400 Dele & Dhi

4.2. Kullotja në Pyllin e Gjenerukës, Divjakë

- **Pylli i Gjenerukës** është zonë e kontrolluar e kullotjes, pjesë e kullotave publike të menaxhuara nga autoritetet lokale (bashki).
- Kultivuesit/farmerët duhet të regjistrojnë bagëtinë dhe të marrin leje për kullotje sezonale – një praktikë e zakonshme në menaxhim zyrtar të pyjeve publike.
- **Veterinerët zyrtarë** monitorojnë shëndetin e kafshëve në kullotje dhe kontrollojnë mundësinë e përhapjes së sëmundjeve.
- Nëse nuk respektohen rregullat (mbi numër kafshësh, kalon kohën e lejuar, pa vaksinim/vizitë veterinarie), mund të vendosen gjoba si nga sektori veterinar, ashtu edhe nga inspektorët e mjedisit.

4.3. Produktet pyjore që përdoren

Drutë e zjarrit.

Në qytetin e Divjakës, si në shumë zona rurale dhe gjysmë-urbane të Shqipërisë, përdorimi i **produkteve pyjore**, sidomos i **druve të zjarrit**, mbetet shumë i përhapur. Ja një listë me disa nga produktet pyjore më të përdorura në Divjakë dhe përdorimi i tyre:

Drurët e zjarrit

Përdorim:

- Ngrohje në dimër (sobat me dru, oxhaqe)
- Gatim tradicional në soba me zjarr druri (sidomos në zonat rurale)
- Përdorim në biznese të vogla (furrat e bukës tradicionale, piceri me dru, etj.)

Llojet më të përdorura:

- **Lisi** (drurë të fortë, digjen ngadalë)
- **Ulliri** (djegie e fortë, aromë karakteristike)
- **Pisha** (djegie më e shpejtë, përdoret për ndezje)

Lëvore pemësh dhe gjethe të thata

Përdorim:

- Ndezje e shpejtë e sobave
- Kompost për bujqësi ose përdorim në kopshtari

Qymyr druri (në sasi të vogla)

Përdorim:

- Pjekje në skarë
- Përdorim në disa biznese gastronomike të zones

5.Zonat konkrete ku prodhohen / mblidhen drutë e zjarrit në Divjakë:

1. **Fshati Gradishtë** – zonë me shumë pemishte të vjetra dhe pyje të rralla me lis.

2. **Fshati Remas** – pranë pyjeve dytësore dhe mbeturinave pyjore, përdoret shpesh për prerje me leje.
3. **Pylli i Divjakës (zona jashtë parkut të mbrojtur)** – pjesë me pisha dhe frashër.
4. **Mucias dhe Cermë-Sektor** – zona bujqësore me shumë pemë frutore të vjetra (ullinj dhe fiq) që shpesh priten për dru zjarri.
5. **Tërbufi (zona e fushës)** – më shumë shelg dhe pemë të buta pranë kanaleve.

Lloji I drurit	Karakteristikat	Zona ku gjendet
Lisi (Quercus spp.)	Djegie e ngadaltë, shumë e fortë, jep shumë nxehtësi	Periferitë lindore të Divjakës (fshatrat Gradishtë, Remas, Mucias)
Ulliri (Olea europaea)	Djegie e gjatë dhe aromë, përdoret edhe për soba	Kopshtet e vjetra të ullirit (Gradishtë, Cerma, Spolat)
Shelgi dhe Plepi	Djegie e shpejtë, e lehtë, pak nxehtësi – për ndezje	Buzë kanaleve ujore dhe lumenjve në zonën e Tërbufit dhe Remasit
Shkoze	Per djegie	Ne Gjeneruk

- Prerja e drunjve lejohet për pyje të thara ose prerje kontrolli.
- Menaxherët pyjorë bëjnë **vlerësim** dhe kategori: prerje për ngrohje, pastrim, transport.
- Pas prerjes për pastrim, **drute** ndahen falas të familjet në nevojë, tek shkollat dhe kopshtet.
- **Rivendosja**: pasi prerjet bëhen, pyjet komunale lejohen të rigjenerohen me mënyra të natyrshme.

KAPITULLI I TRETË

Kushtet e stacionit

1. Shtrirja, Pozita Gjeografike, Kufinjt.

- Pjesa pyjore e Gradishtë-Gjeneruk mbulon kryesisht parcelat pyjore **jashtë Parkut Kombëtar**.
- Kufizimet territoriale të zonave të menaxhuara zakonisht për prerje kontrolli përfshijnë fshatrat: **Kemishtaj, Mërtish, Gorica, Sopës, Fier-Seman, Gradishtë, Gungas, Spolet dhe Babunjë**.
- Këto parcela përfshijnë sipërfaqe pyjore të ndërthurura mes tokave bujqësore dhe bashkive, ku prerjet e druve të zjarrit bëhen me leje bashkie dhe sipas planit vendor.

Shtrirja dhe Tipologjia

Karakteristika	Përshkrimi
Sipërfaqe e përkufizuar	Zbatohen nga plani vendor – pyjet komunale përreth Gradishtë e Gungas.
Kufijtë administrative	Brenda zonës administrative të Gradishtë (të ndara në parcelë kadastrale).
Terreni	Pjellor, me lartësi të vogël (8–22 m), kombinim me fusha bujqësore
Formati I parcelave	Sipërfaqe të vogla-mesatare, shpesh hashërrime pyjore të ndërthurura me vreshta e ullishta.
Shfrytëzimi	Prerje për ngrohje përgjatë korridoreve pyjore, pa prek parkun kombëtar – përdorim tradicional lokal.

1.2. Pozita Gjeografike dhe Rajonale

Qyteti i Divjakës ndodhet në pjesën jugperëndimore të Shqipërisë, në qarkun e Fierit. Kufizohet nga:

- Veriu: Bashkia Lushnje
- Lindja: Njësitë administrative Gradishtë dhe Remas
- Jugu: Lumi Seman dhe bashkia Fier
- Perëndimi: Deti Adriatik

Per sa i përketë Pyllit të Gjenerukes në anët e horizontit ajo kufizohet nga :

Në Veri :Rruga e kalldrëmit

Në Lindje :Ballat

Në Jug :Rezervuari I Spolatit

Në Perëndim : Ara e kërceve.

Zona administrative: Gradishtë – Gjeneruk,

Lartësia mbi nivelin e detit:

- Rrafsh i thatë mesatarisht **22 m**
- Minimalisht rreth **6 m** (zona të lagështa/fushore)
- Maksimalisht deri në **150 m** në skajet më të larta

1.3. Forma e Territorit dhe Relievi

- **Reliev kodrinor.**
- **Variacione minimale** në lartësi në pjesët qendrore, ndërsa në periferi mund të ketë valëzime deri max. **180 m**, megjithëse në pjesët komunale pyjore lartësia zakonisht mbetet nën **40 m**
- Dallime lokale në distancë të ngushtë: pjesë të ulëta argjilore pranë kanaleve, zhvillime pak më të larta drejt lindjes

2. Tokë dhe Origjinë Gjeologjike

- Territori është pjesë e ulëtorës aluvionale të Myzeqesë, formuar kryesisht nga lumenjtë **Seman** dhe sistemi i kanaleve kulluese.
- Shtresat tokësore përfshijnë:
- Tokat janë të pasura me humus dhe material organik në zonat pyjore të lagështa.
- Zonat e pyjeve dytësore (Gradishtë, Gjeneruk, Mucias) kanë toka **argjilore–ranore**, **•Rërë–argjilë** në sipërfaqet pak më të ngritura, më pjellore – ideale për pyllësi komunale dhe pemë të buta, të përshtatshme për rritjen e specieve pyjore të qëndrueshme si **lisi, frashëri, pishë** etj. Formimi i tokës është i favorshëm për rigjenerim pyjor dhe mbjellje të sërishme të drurëve përshtatshëm.

2.1. Kushtet e punës

Organizimi i punës për hartimin e planit të mbarështrimit është mbështetur në metodat më efikase të paracaktuara nga Manuali i Mbarështrimit. Grupi i mbarështrimit ka lëvizur me mjete motorrike nga qyteti i Divjakës . Rrjeti rrugor i qëndrueshëm garanton lëvizje të shpejtë për fillimin në kohën e punës.

2.2. Hidrologjia dhe Ndikimi i Ujit

Zona përfshin një rrjet **kanalësh kulluese dhe vaditëse**, të shkaktuara nga projekti i bonifikimit të viteve '60–'80.

Ka prani të vogël përrenjsh sezonalë që ndikojnë në zonat më të ulëta (zakonisht pranë Gjenerukut).

Zona është e ndjeshme ndaj përmbytjeve sezonale – faktor që duhet marrë parasysh në këshillimin e mbjelljeve dhe menaxhimit pyjor.

Pyjet në Gradishtë–Gjeneruk gjenden në kodrat te buta deri.

- Lartësia karakteristike e sipërfaqeve pyjore është midis 10 dhe 30 m mbi nivel deti – kjo e bën zonën mirë të aksesueshme dhe të menaxhueshme.
- Relievi është i përshtatshëm për operacione pyjore, me rrugë administrimi dhe klimat mbështetëse për species vendase.

Përmbledhje e elementëve morfologjike

Karakteristikë	Vlera per zonën e gjenerukës
Tipi I Relievit	kodrinor
Lartësia mesatare	70 m mbi nivelin e detit
MIN-MAX Lartësisë	60 m deri 90 m
Formimi i Tokës	Aluvional (argjilore/ranore)
Ndjeshmëria ndaj ujrave	Mesatare–e lartë (në pjesë të ulta)

2.3. Pjerrësia

Reliev kodrinor i ëmbël i parcelës nuk ka pjerrësi të madhe. Pjerrësia është 15%.

2.4. Relievi

Relievi që e karakterizon këtë sipërfaqe është i tipit kodrinor. Megjithatë fragmentimet e terrenit në kundërtim të ndryshme nuk mungojnë të ndryshme nuk mungojnë.

2.5. Rrjet rrugor – Zonës Gradishtë–Gjeneruk

Rruga kryesore asfaltore lidh Divjakën me Gradishtën dhe vijon drejt Gjenerukut. Ky segment është i mirë-përdorshëm me lehtësi nga automjetet administrative dhe pyjore.

Rrugë dytësore betoni/asfalti kalojnë brenda parcelave pyjore.


Korridore intra-parcelare: rrugë tokësore (shtruar me gurë ose të ngjeshura) që ndihmojnë lëvizjen e makinave pyjore dhe zhvendosjen e druve apo dhe të zjarrefikesve.

Rrjetet janë mirë të lidhura me aksin paralel të kanalit kullues kryesor, lehtë për akses gjatë gjithë vitit.

Përmbytjet sezonale mund të shkaktojnë pezullime në rrugët tokësore gjatë dimrit dhe pranverës – nevojë për mirëmbajtje konstante.

2.6. Reshjet

Muaji	Reshje (mm)
Janar	120
Shkurt	90
Mars	80
Prill	60
Maj	40
Qershor	25
Korrik	10
Gusht	20
Shtator	40
Tetor	70
Nëntor	145
Dhjetor	110



- **Dimri:** i butë, i lagësht – reshje të shpeshta, rrugë tokësore mund të jenë të vështira.
- **Vera:** e nxehtë, e thatë dhe shumë diell – ideale për aktivitetet vreshtore, por kërkon ujtitje për speciet e reja pyjore.
- **Pranvera & Vjeshta:** dimensione mesatare për temperaturë dhe reshje – periudha më e mirë për mbjellje.

Klima është mesdhetare dhe është një klime jo e shëndetshme sepse ka shume kontraste midis stineve.

- Temperatura mesatare shumëvjeçare vjetore është 21 °C.
- Temperatura mesatare shumëvjeçare e janarit është 5 °C.
- Temperatura mesatare shumëvjeçare e korrikut është 30 °C.
- Temperatura minimale absolute është -1 °C.

- Temperatura maksimale absolute është + 38 °C.

2.7. EROZIONI

2.8. Erozioni bregdetar në Divjakë dhe Rezervatin Rrushkull

